

## **PERMBLEDHEJ E RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS TE LINJES SE RIKUPERIMIT TE MBETJEVE JO TE RREZIKSHME TE SKORJEVE TE ÇELIKUT**

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta industrial në Shqipëri mbetet ende në nivele të ultë si nga subjektet private ashtu dhe nga shteti. Për këtë arsye mbetjet e ngurta në Shqipëri shtohen çdo vit e më shumë, dhe kryesisht nga mbetjet industriale (për shkak të ndërtimeve të shumta dhe prishja e ndërtesave të vjetra, nga proceset teknologjike të aktiviteteve të ndryshme industriale dhe mos trajtimit të tyre etj) dhe mbetjeve urbane (për shkak të rritjes së konsumit të mallrave). Mbetjet janë një problem si për natyrën edhe për njeriun, ato ndikojnë në ndotjen e mjedisit, ujit dhe të ajrit, element të cilët ndikojnë drejtpërdrejtë në mirëqenien e njeriut.

Ky aktivitet nga ana e subjektit "PHL" sh.p.k. trajton kryesisht menaxhimin e mbetjeve të riciklueshme jo të rezikshme siç janë ato të skorjeve të çelikut të cilat kanë kohë që janë të depozituara dhe deri me sot nuk kanë gjetur fushë përdorimi.

**Legjislacionet mbi mbetjet në Shqipëri si dhe disa ligje, vendime e udhëzime që janë pasur parasyh nga subjekti për hatimin e permbledhjes së VNM-se.**

Në Republikën e Shqipërisë kemi një legjislacion të plotë i cili rregullon në mënyrë të hollësishme mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e biodiversitetit dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta.

**Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 për mbrojtjen e mjedisit**, ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e dëmshëm ndaj jetës dhe shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Gjithashtu në ligjin për mbrojtjen e mjedisit parashikohet mënyra e realizimit të mbrojtjes së tujduke ruajtur njëkohësisht burimet natyrore, përmes kursimit, përdorimit të efektshëm apo zëvendësimit të lëndëve të para natyrore e të materialeve të përfuara prej tyre dhe ripërdorimit, riciklimit e rikuperimit të mbetjeve. Në dispozitat e fundit të ligjit parashikohen edhe një sërë masash administrative, për të gjithë subjektet që janë të detyruar të zbatojnë pjesën urdhëruese të tij, dhe të vetëdijshme për këtë gjë këto subjekte lejojnë shkelje të ligjit.

**Ligji Nr. 9587, datë 20.7.2006 për Mbrojtjen e Biodiversitetit**, ka për qëllim të sigurojë mbrojtjen dhe ruajtjen e diversitetit biologjik, si dhe të rregullojë përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të diversitetit biologjik, nëpërmjet integritetit të elementeve kryesore të biodiversitetit në strategjitë, planet, programet dhe vendimarrjet e të gjitha niveleve. Ky ligj përcakton në mënyrë të detajuar institucionet për ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit, instrumentet e planifikimit të biodiversitetit, mënyrën e ruajtjes së ekosistemeve, habitateve dhe peizazheve, që ndodhen jashtë rrejtës së përfatësues të zonave të mbrojtura, si dhe sanksionet për çdo organ shtetëror, organizatë shoqërore dhe person fizik ose juridik që kërcënon ose dëmton biodiversitetin.

- **Ligji Nr. 10 463, datë 22.9.2011 për menaxhimin e integruar të mbetjeve**. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji u shfuqizua ligji nr. 9010, datë 13.2.2003 si dhe çdo ligj dhe akt nënligjor tjetër që bie në kundërshtim me të.

Ky ligj ka për qëllim të mbrojë mjedisin e shëndetin e njeriut dhe të sigurojë menaxhimin e duhur mjedisor të mbetjeve nëpërmjet

- a) Parandalimit e minimizimit të mbetjeve ose pakësimit të ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve.
- b) Përmirësimin të efikasitetit të përdorimit të tyre.
- c) Pakësimin të ndikimeve negative të përgjithshme nga përdorimi i burimeve.

Në ligj përcaktohen dhe specifikohen të gjitha kategoritë e mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, mënyrat e menaxhimit të këtyre mbetjeve duke filluar nga kontrolli, përzierja etiketimi dhe dorëzimi i tyre. Gjithashtu në ligj përcaktohen kategoritë e landfill-eve, kupërfshihen:

- a) Landfille për mbetjet e rrezikshme.
- b) Landfille për mbetjet jo të rrezikshme.
- c) Landfille për mbetjet inerte.

- *Vendimi i KM, nr. 99, datë 18.02.02005 "Për Miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve".*

### **Ligji Nr.10448, datë 14.07.2011, "Për Lejet e Mjedisit".**

Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës. Përcakton detyrimet për Pajisjen me Leje Mjedisore të subjekteve fizike dhe juridike që kërkojnë të ushtrojnë një veprimtari që ka ndikime në mjedis. Kreu IV i këtij ligji "Leja për veprimtaritë që ndikojnë në mjedis" Nenet 35-48 përcaktojnë modalitetet e marrjes së lejes mjedisore.

- **Ligji Nr. 9010, datë 13.02.2003 "Për administrimin mjedisor të Mbetjeve të Ngurta".**

Ky ligj synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta, nëpërmjet administrimit mjedisor të tyre në çdo fazë, përfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin, të cilat çojnë në pakësimin e mbetjeve dhe zvogëlimin e ndikimeve të tyre të rrezikshme e të dëmshme.

- **Ligji Nr. 9115, datë 24.07.2003 "Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotur"**

Ky ligj ka për qëllim të mbrojtë mjedisin dhe shëndetin e njeriut nga ndikimet negative të ujërave të ndotura, duke përcaktuar rregullat e trajtimit mjedisor të tyre, si dhe detyrimet e shkarkuesve të ujërave të ndotura.

Objekt i zbatimit të këtij ligji janë:

**a) ujërat e ndotura urbane; b) ujërat e ndotura industriale, sipas degëve të veçanta të industrisë; c) ujërat nga kullimi i tokave bujqësore; ç) ujërat e ndotura të çdo lloji.**

Në përputhje me kërkesat e këtij ligji, personat fizikë dhe juridike duhet të marrin masa që të ulin në vijimësi sasinë e ujërave të përdorura, që shkarkojnë në mjedisin pritës dhe të pakësojnë shkallën e ndotjes së ujërave që shkarkojnë, sidomos të ndotjeve me lëndë e mbetje të rrezikshme (shkronja a dhe b e pikës 1 të nenit 6).

**Ligji Nr.9774, datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis"** Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e shëndetit dhe e mjedisit nga zhurmat, duke përcaktuar mënyrën e shmangies dhe masat për parandalimin, reduktimin dhe zhdukjen e efekteve të dëmshme të ekspozimit ndaj tyre, përfshirë bezdinë nga zhurma. Ligji zbatohet për zhurmën, ndaj së cilës njerëzit ekspozohen në mjedisin ku ndodhen (mjediset e zonave të banimit, institucionet e ndryshme, zonat me aktivitet social-ekonomi, mjediset urbane dhe parqet publike). Ligji nuk zbatohet për zhurmën e lëshuar brenda vendeve të punës.

Legjislacioni mjedisor është ndërtuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponentë të veçantë dhe të rëndësishëm të mjedisit. Kështu, ndër më specifikët mund të përmendim:

- Ligji Nr. 8766, datë 05.04.2001, "Të mbrojtjes ndaj zjarrit".
- Ligji Nr. 9108, datë 17.07.2003, " Për substancat dhe preparatet kimike".
- Ligji Nr.9290, datë 07.10.2004, "Për produktet e ndërtimit".
- V.K.M. Nr.1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit".



- V.K.M. Nr. 435, datë 12.09.2002, “Për normat e shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”.
- V.K.M. Nr. 249, datë 24.04.2003, “Për dokumentacionin për Leje Mjedisore dhe të elementëve të Lejes Mjedisore”.
- V.K.M. Nr. 177, datë 31.05.2005, “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngta dhe kriteret e zonimit të mjedisëve ujore pritëse”.
- Udhezimi Nr.429, datë 17.11.2009, i Ministrisë së Mjedisit, “Për rregullat dhe procedurat për paisjen me leje mjedisi në kuadër të Qendrës Kombëtare të Liçensimit”.
- V.K.M.Nr.587, datë 07.07.2010, “Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike”.
- Udhëzimin Nr.8, datë 27.11.2007, “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedisë të caktuara.
- Ligji Nr.8906 datë 6.6.2002 “Për Zonat e Mbrojtura i azhurnuar me ligjin nr.9868 datë 04.02.2008

Në ligj parashikohen dhe ndalimet përkatëse për importimin dhe transitimin nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë të të gjitha kategorive të mbetjeve të rrezikshme. Ndalohet gjithashtu importimi i mbetjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë për qëllim ruajtjeje apo asgjësimi. Ligji rregullon gjithashtu edhe të gjitha kategoritë e mbetjeve jo të rrezikshme që lejohen të importohen dhe rregullat përkatëse për importimin e mbetjeve. Ligji përcakton edhe kategoritë e mbetjeve jo të rrezikshme që lejohet të transferohen nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe kategoritë e mbetjeve që eksportohen nga Republika e Shqipërisë.

### ***Mbetjet e ngurta.***

Ndotja e mjedisit është një fenomen i cili prek jo vetëm të gjithë shoqërinë Shqiptare por edhe atë botërore. Ashtu si ngrohje globale edhe ndotja e mjedisit është një rrezik për biodiversitetin, e cili rrjedh nga konsumi i lëndëve djegëse si: Nafta, benzina, benzoli etj. Por kryesisht nga mbetjet e ngurta, grumbullimi, dekompozimi dhe djegia e tyre. Mbetjet e ngurtë janë lëndë të cilat nuk përdoret me ose që zotëruesi do ti hedhë ato. Pjesë e tyre vlerësohet si mbetje për sa kohë që energjia e prodhuar prej tyre nuk përfshihet në procesin e prodhimit.

### ***Disa nga mbetjet e ngurta janë:***

***Mbetje organike,*** janë ushqyesit biologjikë që në fund të ciklit të tyre jetësor , mund të dekompozohen në mënyrë të sigurt e të shpejtë e mund ti kthejmë në tokë.

***Mbetje inerte,*** janë ato mbetje që nuk i nënshtrohen ndonjë transformimi të rëndësishëm fizik, kimik apo biologjik. Mbetjet inerte nuk treten, nuk digjen, nuk ndërveprojnë fizikisht dhe as nuk hyjnë në reaksione kimike, nuk biodegradohen e nuk ndikojnë negativisht në lëndë të tjera, me të cilat bien në kontakt, në mënyrë të tillë që mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit ose të dëmtojnë shëndetin e njeriut.

***Mbetje bio,*** janë mbetjet e biodegradueshme, treten tërësisht dhe janë mbetje ngakopshtet e shtëpive, parqet, mbetjet ushqimore, të gatimit nga shtëpitë, restorantet dhedyqanet e shitjes me pakicë, si dhe mbetjet e ngjashme nga impiantet e përpunimit të ushqimeve.

***Mbetje urbane,*** përfshijnë një shumëllojshmëri mbetjesh, ato janë mbetjet e shtëpive, të ndërtesave administrative, sociale dhe publike, duke përfshirë në këtë kategori edhe mbetjet që vijnë si rezultat i veprimtarisë tregtare, vendet e pushimit dhe argëtimit etj.

**Mbetje spitalore**, janë mbetje të krijuara nga spitale, shërbime shëndetësore ose institucione shëndetësore kërkimore, ku përfshijnë material të rrezikshme dhe jo të rrezikshme.

**Mbetje të rrezikshme**, janë ato mbetje që shfaqin një ose më shumë nga vetitë e rrezikshme si: Shpërthyes, oksiduese, të djegshme, toksike, kancerogjene, mutagjenike, infektuese, toksike për riprodhimin, gërryese etj. Të gjitha këto veti konsiderohen të dëmshme si për njeriun dhe për mjedisin.

**Mbetje industriale**, janë mbetjet e krijuara nga veprimtaritë industriale, artizanale dhe nga shërbimet, janë të dëmshme pasi një pjesë e madhe e tyre përbehet nga material plastike dhe plasmasi, të cilat konsiderohen të dëmshme në procesin e djegies dhe në procesin e groposjes së tyre.

**Mbetje të riciklueshme**, janë të gjitha mbetjet të cilat mund të konvertohen si lëndë e pare për të prodhuar produkt apo material në dobi të konsumatorit. Jo të gjitha mbetjet e ngurta janë të rrezikshme, disa prej tyre nuk paraqesin kërcënim të madh as për njeriun dhe as për mjedisin, të tilla janë mbetjet organike ose mbetjet e inerteve, të cilat janë dekompozohen në tokë pa shkaktuar dëm. Por fakti që nuk janë të dëmshme nuk do të thotë që duhen detyrimisht të digjen ose të groposen (mbetjet organike), ato do të ishin shumë më tepër të dobishme nëse dotë ricikloheshin për tu ripërdorur. Nga të gjitha mbetjet e ngurta që grumbullon pushteti lokal vetëm një pjesë e vogël e tyre riciklohen nga kompanitë private, ndërsa pjesa tjetër shkon ose për djegie të lirë në vend depozitimit të mbetjeve të çdo qyteti ose për groposje në landfill, ndërsa mbetjet inerte hidhen vend e pavend.

### **Riciklim.**

Termi riciklim do të thotë çdo operacion rikuperimi, me anë të të cilit materialet e mbetjeve ripërpunohen për t'u shndërruar në produkte, materiale apo substanca, për t'u përdorur, si për qëllimin fillestar, ashtu edhe për qëllime të tjera. Ndër mbetjet më të kërkuara për riciklim janë: metal (kryesisht skrap), letër, karton, tulla, bateri, qelq, pajisje elektronike, dru, plastika etj. Vlera që kanë mbetjet e riciklueshme ka bërë që të krijohen biznese në sektorin e riciklimit për të përfutur ekonomikisht dhe për të dhënë një kontribut për përmirësimin e kushteve mjedisore me anë të rikuperimit të mbetjeve. Riciklimi përfshin ripërpunimin e materialeve organike, por nuk përfshin rikuperimin e energjisë dhe ripërpunimin që u bëhet mbetjeve për ti shndërruar në materiale që përdoren si lëndë djegëse apo si lëndë mbushëse. Riciklimi i mbetjeve ndihmon mjediset tona. Grumbullimi i mbetjeve sjell një mjedis më të pastër për në e fëmijët, kurse riciklimi i tyre mbron burimet e pasuritë natyrore që të mos shteren kurrë.

### **Çfarë përfitohet nga riciklimi i mbetjeve?**

1-Mjedisi, sepse mbetjet që do të groposen në landfill do ju duhen një kohe e gjatë për dekompozim, dhe mbetjet që do të digjen do shkaktojnë ndotje të ajrit.

2- Do të shtohet jetëgjatësia e landfill-eve, sepse do të groposen vetëm një pjesë e sasisë së përgjithshme të mbetjeve.

3-Reduktim i transportit të mbetjeve për në landfill, përfiton mos dëmtimi i rrugëve, kohë, karburant, amortizim të mjeteve të transportit etj.

4- Biznesi dhe pushteti lokal do të fitojnë nga ana financiare, nga investimet dhe nga taksat.

5-Do të hapen vende pune, në sektorin e grumbullimit dhe të përpunimit të mbetjeve, etj.

### **Menaxhimi i mbetjeve nga sektori publik.**



Diskutimet mbi menaxhimin e mbetjeve të ngurta në Shqipëri janë ato më të shpeshta në lidhje me çështjet sociale në vend. Një shqetësim që nuk po i gjendet një zgjidhje përfundimtare, pasi me kalimin e kohës hipotezat dhe opsionet për një zgjidhje të mundshme shtohen duke i tejzgjatur procedurat e zbatimit të një plani konkret. Çështja që shtrohet në diskutim mbi menaxhimin e mbetjeve është se cila nga metodat e asgjësimit të mbetjeve duhet aplikuar në mënyrë që mjedisi të ketë një ndikim negativ sa më të vogël.

**Metodat e trajtimit të mbetjeve: 1-Kompostimi. 2- Djegie. 3-Groposja (Landfill). 4- Riciklim.**

**Kompostimi** është një mënyrë e mirë për të ricikluar mbetjet organike. Kjo bëhet me mbetjet që kërkojnë një kohë shumë të shkurtër për degradim, për këtë metodë përdoren kryesisht mbetjet shtëpiake. Kompostimi mundëson shëndrimin e mbetjeve në pleh organik në dobi të tokës. Kjo kërkon një seleksionim të mbetjeve në një kategori të veçantë ku mbetjet të kenë veti të tretshmërisë (Braun, 2000). Mënyra e kompostimit nuk praktikohet në vendin tonë sepse kërkon organizim të gjerë për grumbullimin dhe seleksionimin e mbetjeve të nevojshme dhe organet kompetente qeveritare nuk i mundësojnë këto shërbime.

**Djegie** është një metodë që mundëson asgjësimin e mbetjeve duke i shkrirë ato në temperaturë të lartë në ambient të izoluar. Djegia realizohet me anë të inceneratoreve izolues dhe kjo praktikohet ende në metalurgjikun e rrethit të Elbasanit. Incenerimi është edhe një mënyrë për të prodhuar energji. Vende si: Gjermani, Holandë, Suedi, Danimarkë, Austri etj. e shfrytëzojnë incenerimin në masën 35%-55% (Gjoka K., Environmental programmemenager, 2011) dhe mundohet të përfitojnë sa më shumë energji prej saj. Në vendin tonë incenerimi bëhet kryesisht vetëm për mbetjet e rrezikshme siç janë mbetjet spitalore dhe kjo duke mos shfrytëzuar mundësinë e prodhimit të energjisë ashtu siç bënë një pjesë e madhe e vendeve në botë. Djegia e mbetjeve është shkaku kryesor i ndotjes së ambientit, pasi çliron gazra të ndryshme të cilat ndikojnë negativisht në atmosferë duke rritur rrezikshmërinë e ngrohjes globale dhe rrezikun e sëmundjeve dhe infeksioneve të ndryshme si pasojë e ndotjes së ajrit në vend.

**Riciklimi** është metoda më efiçente për të asgjësuar mbetjet e ngurta, por kjo kërkon një organizim të gjerë nga ana e sektorit publik në bashkëpunim me sektorin privat. Riciklimi është procesi në të cilin materialet që janë destinuar për eliminim, mund të grumbullohen, ripërpunohen, riprodhohen dhe përdoren sërish si lëndë e parë. Në Shqipëri pjesa më e madhe e mbetjeve të ricikluar si: Letra, plastika dhe qelqi, materialet inerte, të cilat mund të riciklohen tërësisht nuk mundësohen kushtet e nevojshme dhe të mjaftueshme për seleksionimin dhe grumbullimin e këtyre mbetjeve. Përdorimi i riciklimit në Shqipëri arrin deri në 25% të mbetjeve, shumë e ulët kjo në krahasim me vendet në zhvillim si: Gjermania, Holanda, Suedia, Austri etj. ku arrin deri në 60% të riciklimit të mbetjeve të vendit.

**Groposja (Landfill)** është asgjësimi i mbetjeve të ngurta në një zonë të caktuar ku degradimi i tyre ndodh në tokë. Për vendet në zhvillim si: Shqipëria, Rumania, Bullgari, Çeki, Slloveni etj. 75%-85% e mbetjeve të ngurta shkojnë në landfill (Gjoka K., Environmental programmemenager, 2011). Përdorimi i landfill-it konsiderohet si mënyra më e shpejtë për asgjësimin e mbetjeve të vendit, por kjo nuk është mënyra më e sigurt dhe e këshillueshme pasi ka efektanësore si në ambient edhe në shoqëri. Në Shqipëri mbetjet depozitohen në landfill pa një seleksionim të llojeve të tyre dhe kjo bënë që degradimi i këtyre mbetjeve të kërkojë njëkohëzgjatje më të madhe nga ajo që u nevojitet. Gjithashtu, groposja e pa kontrolluar e mbetjeve rrit dëmin që i shkaktohet tokës nga çlirimi i gazrave dhe toksinave gjatë dekompozimit të mbetjeve të ndryshme.

## **PERSHKRIMI I PROÇESEVE TEKNOLOGJIKE**

KURUM International Sh.a përdor skemën e prodhimit të çeliqueve nga riciklimi i skrapeve ferrozë të perpunuar paraprakisht e më pas behet shkrirja e tyre (skrapeve ferrozë) dhe zhvillohen operacionet metalurgjike në furrë elektrike me hark për perfitimin e çelikut të lenget; kryhet perpunimi i metejshëm i çelikut të lenget në kove dhe më pas realizohet derdhja e tij (e çelikut) në makinën e derdhjes panderprere në formë kallesh të standartizuara me seksion terthor kuadrat, të ashtuquajtura billeta. Më tej realizohet

petezimi ne te nxehte i kalleve te celikut per te perfituar shufra te gatshme te celiqeve ne perputhje me formen dhe dimensionet standarte te kerkuara nga tregu.

### *Skorjet e celikut te cilet dalin gjate procesit te prodhimit.*

Çeliku i lëngët, pasi të ketë arritur përbërjen kimike dhe temperaturën e dëshiruar, derdhet në kovën e vendosur poshtë furrës.

Derdhja e çelikut të lëngët nga FEH realizohet nga poshtë dhe gjatë hedhjes së metalit në kovë bëhet hedhja e ferrolidhjeve në sasinë e duhur sipas markës së kërkuar.

Gjatë procesit të shkrirjes, pikërisht gjatë fazës së oksidimit të ngarkesës metalike, realizohet largimi i skories së formuar.

### **Skoriet e FEH**

Sasia e skories së prodhuar gjatë gjithë procesit është në vlerat  $12 \div 14$  % të sasisë së çelikut të prodhuar;  $60 \div 65$  % e kësaj sasive prodhohet drejtpërsëdrejti në FEH, pjesa tjetër në furrën kovë.

Përbërja kimike e skories të FEH dhe furrës kovë, për prodhimin e çeliqeve me karbon (çeliqe për ndërtim) është dhënë në tabelën më poshtë.

Përbërja kimike e skories të FEH (KURUM International).

Përbërësi, % në peshë	Skoria	
	FEH	Furra kovë
Fe <sub>tot</sub>	10 – 32	≤ 2 - 5
CaO	25 – 45	30 - 50
CaO <sub>i lirë</sub>	≤ 4	≤ 10
SiO <sub>2</sub>	10 – 18	10 – 20
Al <sub>2</sub> O <sub>3</sub>	3 - 8	3 - 12
MgO	4 – 13	7 - 18
MnO	4 – 12	≤ 1 - 5
Cr <sub>2</sub> O <sub>3</sub>	1 - 2	≤ 0.5
TiO <sub>2</sub>	0.3	
P <sub>2</sub> O <sub>5</sub>	0.01 – 0.6	
V <sub>2</sub> O <sub>5</sub>	0.11 – 0.25	
NiO	0.1 – 0.4	



Nëse do të pranohet se KURUM International prodhon  $150,000 \div 200,000$  ton çeliqe në vit, sasia vjetore e skories së prodhuar në FEH do të jetë rreth  $20 \div 28$  mijë ton në vit. Sipas planifikimit mund të prodhohen dhe rreth 48mije ton per vite ne vazhdim

Skoriet e prodhuara depozitohen në vendgrumbullimin e ish KME, që ndodhet pranë lumit Shkumbin dhe ne sheshin e uzines celikut . Kohet e fundit ka gjetur vend perdorim te skorieve te dala nga procesi shkrirjes çelikut duke ja levuuar kompanive te ndertimit te rugeve .

Konkretisht gjate vitit te fundit ka arritur te evadoje rreth 75000 ton nga keto skorie per nevoja te industrise se ndertimit te rugeve.



Në vendin tonë akoma mungon një legjislacion për vendgroposjet (landfill-et).  
Skorjet e depozituara ne sheshin e grumbullimit te mbetjeve trajtohen nesipas kesa skeme teknologjike



Skema teknologjike

**A** GABINA PER LIDHJEN E  
KORENDIT NGA KORUMI

**B** PULT KOMANDIMI

**C** MAGAZINA PER VEGLAT E  
PUNES

① Silloz 8 m<sup>3</sup> ku shkarkohet skorja

② Transportjer 60x3000 me fuqi te  
instaluar 1.1kw

③ Site elektrike per ndarjen e reres  
nga konglomerati, me fuqi 15kv

④ Transportjer 60x7000 me fuqi te  
instaluar 1.1kw

Site me dy vibrator me fuqi 0.42  
secili, per ndarjen e konglomeratit  
ne tre lloj fraksjonesh

⑥ Transportjer 60x4500 me fuqi te  
instaluar 1.1kw

⑦ Transportjer 60x8000 me fuqi te  
instaluar 1.1kw

### *Efekt i përdorimit të teknologjisë.*

Është e provuar se trajtimi i mbetjeve nga punonjësit e kompanisë në momentin e ngarkimit, shkarkimit dhe seleksionimit, nuk kanë asnjë efekt anësor mbi personat që punojnë. Stafi përbërës i cili ka lidhje të drejtpërdrejt me trajtimin e mbetjeve janë të trajnuar dhe të udhëzuar për të përdorur masa mbrojtëse gjatë kohës së veprimtarisë. Ndërsa teknologjia e përdorur për trajtimin e tyre, nuk ka asnjë ndikim negativ as në ambientet e brendshme të kompanisë as në mjedis.

Ndikime ne ajer: nuk ka. Gjate procesit te seleksionimit nuk ka çlirime gazrash, pluhurash (sepse behet sprucimi me uje)

Ndikime ne uje: gjate seleksionimit te skorjeve nuk ka clirim te ujrave

Ndikime ne toke: nuk ka : sheshi eshte I betonuar dhe materialet evadohen direct per ne destinacion(shtrimin e rrugeve)

Ndikime ne zhurma: jane minimale dhe keto vijne kryesishty gjate punes s etransportjereve dhe sitave.

### **NJE PËRSHKRIM TE SHKURTER TE MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI.**

Zona qe po merret ne shqyrtim ndodhet ne perendim te fshatit Bradashesh dhe ne juge te fshatit Bradashesh.Vendi ben pjese ne masivet argjilore te zones se Bradasheshit. Ne pergjithesi keto masive argjilore jane te shveshura dhe vende vende me shkurre. Kodrat qe ndodhen ne pjesen veriore jane te buta dhe kane nje pjerrresi 30-50 grade. Nga veprimet e erozjonit ne kodra jane formuar rrekerat te vogla qe kane uje vetem kur bie shi. Kuota me e larte e zones vertitet reth 445 metra.

Zona ne shfrytezim eshte pjese e ish uzines se çelikut se kombinatit metalurgjik(sot e rikonstruktuar si ne ndertim ashtu dhe ne teknologji e kapacitete). Shtepia e fundit te fshatit Bradashesh jane rreth 1km larg kesaj zone.

Kodrat ne veri ne pjese te vecanta jane te mbjella me ullinj.

Ne pjesen Jugore te projektit ndodhet ne nje distance rreth 1 km shtrati i lumit te Shkumbinit per ujrat e te cilit do te flitet me poshte

Terreni eshte kryesisht me relief fushor. Vendi ku do te zhvillohet veprimtaria eshte zone industriale, flora e zones perreth perbehet nga bimesi mesdhetare. Bimësia natyrore përfaqësohet nga mbeturina të



shkurreve mesdhetare, dushku apo shelgu. Ne fushat rreth fabrikes kultivohen drithërat e bukës: gruri, misri si dhe duhani dhe rrushi. Eshtë zonë e kultivimit të ullirit, fikut kumbullës.

Ne distance me mbi 500 m gjenden banesa te cilat jane ndertuar vitet e fundit, te pakta te cilat kultivojne ne bahçet e tyre bimesi te pakte stines dhe dru frutore. Meqe zona perreth eshte teresisht e industrializuar dhe pjeserisht urbane nuk mund te flitet per faune te eger vetem per ndonje te kafshe shtepiake ushqyer me vlere qytetarie.

Mbulesa bimore e zones ku do te ndertohet linja e furnizimit me uje, nuk demton kullotat, bimesine etj. Gjate ndertimit te objektit ka pasur nje sere ndikimesh te vogla direkte apo indirekte te tilla si pastrime te bimesise, germime dhe spostime dheu per krijimin e pozicioneve te favorshme te linjes etj Mbas perfundimit te punimeve kjo situatë eshte rikthyer si me pare.

Ne kete zone te vleresimit, tokat bujqesore jane te kultivuara ne menyre sistematike nga banoret e zones, pasi jane mjaft produktive dhe te pasura me burime ujore.

Gjelbërimi në zonën e ndërtuar është ai privat me bimësi të ulët e pemë të mbjella në distancë dhe gjelbërimi i rrugëve të brendëshme të kompleksit industrial. Sheshi i objektit mbas përfundimit të punimeve është i mbjellë anash me pemë dekorative

### **Konsiderata te pergjitheshme per biodiversitetin e zones per rreth**

Per shkak te pozicjonit gjeografik, karakteristikave hidrogjeologjike, klimes dhe mikroklimes, relievit etj, zona e Bradasheshit dhe ne veçanti Njesia administrative Bradashesh nuk dallohet per larmi te diversitetit biollogjik dhe te pejsazhit. Habitatet e shumta si pyje, shkurre, kullota dhe toka bujqesore i japin kesaj zone vlere te rëndesishme faunistike e pejsazhiste kombetare dhe rajonale.

**Habitatet dhe biodiversiteti.** Territori i Bradasheshit dallohet për gjelbërimin vetiak. Zona që studiohet ka pasur bimësi të ulët, bar dhe bimësi të vogël e të egër që luajnë një rol pak të rëndësishëm në ekosistemin e zonës. Më parë ajo është përdorur si truall i lirë. Studimi ka parashikuar ekuilibrin e siperfaqes që kthehet në ndërtim me siperfaqen e gjelbëruar. Shpendi më i spikatur për zonën është kumria dhe harabeli të cilat pas ndërtimit dhe shfrytezimit janë larguar dhe spostuar drejt siperfaqeve të gjelbërta të territorit të Njesise administrative Bradashesh. Karakteristikat klimaterike, topografia, tokat ujërat dhe prania e njeriut bëjnë që territori të karakterizohet me habitate me vlere jo të veçanta, karakteristika tipike të habitatit të menaxhuar me intensitet dhe pa vlere pozitive të biodiversitetit. Zona klasifikohet në habitate tokësore të kultivuara dhe të menaxhuara. Territori fushor është i rrethuar nga kodra të mbjella me ullinj, ç'ka tregon për sipërfaqe të tokave të menaxhuara intensivisht dhe me mbulesa gjysëm artificiale të vegjetacionit. Territori në afërsi të zonës ka një mbulesë barishtore të ulët ku shfaqen forma të çikores së egër.

### **PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.**

#### **Informacione mbi cilesine mjedisore ne zonen e studimit.**

Zona qe po studiohet perfshihet ne rrethin e Elbasanit dhe me saktesisht ne Fshatin Bradashesh. Sheshi ku eshte ndertuar eshte prone e "Kurum International"sh.a. dhe ndodhet ne zonen industriale (ish Kombinati Metalurgjik Elbasan-ish uzina e çelikut).

Informacioni mjedisor per kete zone do te ndahet ne informacione ne lidhje me cilesine e ajrit dhe informacione ne lidhje me cilesine e ujrave siperfaqesore.

## Pejsazhi

Vendi i projektit është zgjedhur në mënyrë të tillë, që të zhvillojë dhe të nxjerrë në pah vlerat e një studimi bashkëkohor. Ushtrimi i aktivitetit dhe lidhja e tij me zonat e rëndësisë së veçante. Zona në të cilën është ndertuar objekti perkatese nuk përfshihet në zonat e mbrojtura me ligj si: rezervat kombëtare natyrore, zonat me interes të veçantë shkencor, parqet kombëtare, zonat me bukuri të rrallë natyrore, kanionet dhe brigjet e trashëguara, parqet rajonale dhe rurale, parqet pyjore kombëtare, rezervat lokale natyrore, zonat ujore të mbrojtura.

## Cilësia e ajrit për Elbasanin, Komunën Bradashesh dhe zonën përreth

Zona rezulton me ajër të ndotur si zonë me zhvillim industrial.

Tabela Rezultatet mesatare vjetore për periudhën 2001-2012.

Viti	LNP	LNP	LNP	PM10	PM10	PM10
	Elbasan 1	Elbasan 2	Elbasan 3	Elbasan 1	Elbasan 2	Elbasan 3
	µg/m <sup>3</sup>	µg/m <sup>3</sup>	µg/m <sup>3</sup>	µg/m <sup>3</sup>	µg/m <sup>3</sup>	µg/m <sup>3</sup>
2001	279			127		
2002	366			175		
2003	266			117		
2004	244			112		
2005	249			113		
2006	179			79		
2007		176	195	91	81.5	91
2008		138.65			56.16	
2009		121.5			61.15	
2010		118	168		58.25	81.29
2011		156.48	178		78.24	89
2012				87.63		
<b>Norma AL</b>	140	140	140	70	70	70
<b>Norma KE</b>	80	80	80	40	40	40



Tabela **Rezultatet e matjeve të cilësisë së ajrit, Elbasan - viti 2013**

Nr	Vendi	Data e matjes	LNP μg/m <sup>3</sup>	PM10 μg/m <sup>3</sup>	PM7 μg/m <sup>3</sup>	PM2.5	PM1
						μg/m <sup>3</sup>	μg/m <sup>3</sup>
1	Elbasani 1,DSHP	25-28.03	75	30			
2	Elbasani 1,DSHP	29.03-01.04	77	34			
3	Elbasani 2, Prefektura	30.03	87	73	54	9	1
4	Hyrja e KM, ura e Kushës	30.03	151	127	100	12	2
5	Shkolla Europa, Katund i Ri	30.03	78	65	49	14	4
6	Shkolla A.Leshanaku, Bradashesh 30.03		62	54	44	8	1
7	<b>ACR, fshati Balldre</b>	<b>30.03</b>	<b>74</b>	<b>63</b>	<b>51</b>	<b>11</b>	<b>2</b>
8	ECF, në fshatin Baltëz e Poshtme 30.03		71	51	39	9	1
9	Jashtë KM, mbi burg në rrugë	30.03	73	66	54	18	4
10	Brenda KM, 10m në jug të burgut	30.03	75	69	58	14	3
11	Brenda KM, 10m në jug të burgut	30.03-02.04	67	52			
	<b>Norma AL</b>		140	70		15	
	<b>Norma KE</b>		80	40		20	

Elbasani 1 - zona urbane pranë DSHP

Elbasani 2 - zona e qendrës së qytetit

Elbasani 3 - zona industriale pranë ish KM

### Përmbajtja e grimcave të respirueshme PM10 në ajër



### Qarku i Elbasanit

Tabela Burimet e Ndotjes

Nr.	Burimet e ndotjes	Pikat e monitorimit	Koordinatat	
			Lindje	Veri
1	Kombinati Metalurgjik Elbasan	M1	0416879	4548837
		M2	0416787	4548564
		M3	0416152	4548120
		M4	0418035	4550240
		M5	0419188	4549669
		M6	0416952	4548082
		M7	0415844	4547402
		M8	0415094	4546910

Tabela Karakteristikat fiziko-kimike të tokave pranë objekteve industriale

Nr.	Burimet e ndotjes	Pikat e monitorimit	pH (H <sub>2</sub> O)	Humusi	Përbërja mekanike			Tekstura
					Rërë %	Lym %	Argjilë %	
	Kombinati Metalurgjik Elbasan	M1	8.1	1.85	25.2	52.0	22.8	ZL
		M2	8.3	1.58	30.4	48.0	21.6	L
		M3	8.2	2.57	14.0	60.8	25.2	ZL
		M4	8.1	2.05	44.0	35.2	20.8	L
		M5	7.9	2.89	9.2	53.2	37.6	ZCL
		M6	7.9	2.26	11.4	56.6	32.0	ZCL



	M7	7.9	1.95	15.2	35.6	49.2	C
	M8	8.1	2.73	10.8	63.8	25.4	ZL

Tabela Monitorimi i cilësisë së ajrit urban në qytetin e Elbasanit për periudhën Janar-Nëntor 2014

Nr.	Stacionet	PM <sub>10</sub> µg/m <sup>3</sup>	NO <sub>2</sub> µg/m <sup>3</sup>	O <sub>3</sub> mesatare 8 orare µg/m <sup>3</sup>	SO <sub>2</sub> µg/m <sup>3</sup>	CO µg/m <sup>3</sup>	Benzene
1	Elbasan qendër	49,13	34,72	23,7	13,72	0,7	
2	Elbasan kombinat (Mjedisi tek RSA)	61,97	7,03	37,44	31,94	0,55	2,44
3	Elbasan kombinat Mjedisi tek DOKO	38	6,16	22,24	20,72	0,65	1,75
	Normat shqiptare	60	60	65	60	2	5
	Standarti i BE	40	40				5

**Rezultatet e testimeve sipas burimeve të shkarkimit në oxhak për vitin 2017 (tremujori i parë) janë si vijon :**

Perqendrimet e ndotesve në mg/m<sup>3</sup>, në kushte normale, sipas burimeve të ndotjes

Datat matjeve	Temp. mjedis grade C	Temp. në Oxhak grade C	Presioni A tmosf. mm kHg	Lende engurte	SO <sub>2</sub>	NO <sub>2</sub>	CO	CH <sub>4</sub>
Reparti gelqeres								
11 Shkurt	12	48	755	46	190	15		
18 Mars	18	32	754	45	195	14		
<b>Norma lejuar</b>				<b>50</b>	<b>400</b>	<b>1500</b>		
<b>Uzina Çelikut</b> <i>11 Shkurt</i> <i>oxh.1</i>	12	58	754	39	8	6	735	

<b>Oxhaku 2</b>	12	54	755	36	6	4	575	
18 Mars oxh.nr1	18	60	754	20	9	12	610	
Oxhaku 2	18	56	755	17	7	7	450	
<b>Norma e lejuar</b>				<b>75</b>	<b>400</b>	<b>400</b>	<b>1000</b>	
<b>Linja e skrapit</b>								
11 Shkurt	12		754	Jo pune				
<b>18 Mars</b>	18		755	92	0	0	0	
<i>Norma</i>				<b>100</b>	<b>250</b>	<b>250</b>	<b>100</b>	
<i>Uzina Petezimit</i> <b>Katanka</b>								
<b>11 Shkurt</b>	12	162	754	25	10	215	48	
<i>18Mars</i>	18	153	755	21	9	220	20	
<b>Norma, me gaz</b>				<b>50</b>	<b>35</b>	<b>200</b>	<b>100</b>	
<b>Depozitat e gazit GLN</b>	12		754	0,14	0	0	0	0,9
11 Shkurt								
<b>18 Mars</b>	<b>18</b>		755	0,12	0	0	0	0,7

Cilesia e ajrit ne territorin e projektit eshte normale për nje zone industriale te projektuar posaqerisht për prodhim çeliqesh te petezuara. Ashtu siç u permend edhe me lart, ka shkarkime te pluhrave dhe gazeve te ne ajer.

**Mbetjet:** Nga aktiviteti nuk krijohen mbetje, sepseskorja eshte e paster. Edhe ne se del material metalik ai



do te trajtohet per riciklim duke ja dhene subjekteve te licensuara qe eshte vete Kurum

### **Vlerësimi i ndotjes së tokave bujqësore pranë objekteve industriale**

Ndotja e tokave pranë Kombinatit Metalurgjik Elbasan

Studimi fushor për marrjen e mostrave të tokës u realizua me 12.07.2014. Për analizimin e nivelit të ndotjes nga metalet e rënda në këtë zonë janë përcaktuar 8 pika monitorimi në drejtimin verior, lindor dhe jugperëndimor të objektit industrial. Pika e parë është marrë rreth 70m nga objekti ndërsa e fundit ka një distancë prej rreth 2500m.

Tokat e kësaj zone paraqiten dobësisht dhe mesatarisht alkaline (7.9 deri në 8.3). Nga vlerësimi i përmbajtjes së humusit ato paraqiten mesatare në të gjitha pikat e monitorimit. Përsa i përket teksturës së tokës ajo paraqitet e ndryshme. Në pikat 1, 3 dhe 8 tokat janë të ekuilibruara lymore (ZL), në pikat 2, 4 janë të ekuilibruara (L), në pikat 5, 6 janë të ekuilibruara lymore argjilore (CL), ndërsa pika 7 është argjilore (C).

Lartësitë mbi nivelin e detit variojnë nga 86 m në 109m.

Në lidhje me përmbajtjen e nikelit, kromit, bakrit dhe plumbit nuk ka ndonjë rregullsi me rritjen e largësisë nga objekti.

Të dhënat e analizuar treguan se përqëndrimet e zinkut, manganit dhe kadmiumit janë poshtë vlerave të përcaktuara kritike nga BE.

Të gjitha tokat ku u morën mostrat janë të mbjella me kultura bujqësore. Ato janë të kultivuara kryesisht me jonxhë, grurë, misër dhe pemë frutore.

Tabela

<b>Burimet e ndotjes</b>	<b>Zn</b>	<b>Mn</b>	<b>Ni</b>	<b>Cd</b>	<b>Cr</b>	<b>Cu</b>	<b>As</b>	<b>Pb</b>	<b>Fe</b>
Kombinati Metalurgjik Elbasan	121.7	547.5	<b>478.5</b>	2.2	<b>573.0</b>	<b>452.1</b>	0.0	<b>380.3</b>	4.3
Limitet e lejuara	300	1000	<b>75</b>	3	<b>200</b>	<b>140</b>	1.5	<b>300</b>	20

### **Masat per zbutjen e ndikimeve gjate fazes se shfrytezimit.**

Bazuar ne ndikimin e mesiperm subjekti do te marre masat per kontrollin dhe zbutjen e çdo ndikimi individual. Masat do te jene te karakterit operacional, dhe me veprime konkrete ne mjedis por dhe te karakterit organizativ

**Ndikimi ne toke- nuk ka,** megjithate do te behet kontrolli periodik

**Ndikimi Kimik.** –Nuk ka

**Ndikimi akustik.**– Zhurma prish veprimtarinë dhe ekuilibrin e jetës, qoftë kjo e shkaktuar nga njerëzit apo makinat. Nivelet e zhurmave në mjedis karakterizohen si efekti kumulativ i të gjithë burimeve të mundëshme të zhurmave në një mjedis të caktuar. Zhurmë konsiderohet çdo tingull shqetësues, jo i dëshiruar dhe jo i këndshëm për aparatën e degjimit të çdo njeriu. Impaktet e mundëshme të zhurmave varen në mënyrë të ndjashme nga faktorët e mëposhtem; Intensiteti zhurmës, i cili matet në dB

(decibel), frekuenca e valës e cila matet në Hz (hertz), kohëzgjatja e ekspozimit, Impaktet shëndetësore të shkatuara nga nivelet e larta të zhurmave përmendim, dëmtim të sistemit të dëgjimit. shurdhim i përkohshëm apo i përhershëm, ulja e efikasitetit në punë, nivelet mbi normat e lejuara të zhurmave vepronë si një nxitës i stresit, duke rritur kështu nivelin e stresit midis njerëzve.

Ne përgjithësi, nuk behet fjalë për ndotje akustike pasi nuk kemi të bëjmë me makineri apo pajisje të renda që mund të shkaktojnë zhurma mbi normat e lejuara. Mundësi për krijimin e zhurmave mund të jete në rastet kur behet ngarkim-shkarkimi i materialeve dhe kur ka ndërprerje të energjisë elektrike zhurma që mund të shkaktojë gjeneratori i avarise (n.q.s. do të përdoret një i tillë). Po kështu zhurma shkaktohen dhe në linjen e prodhimit por ndjeshmeria e tyre kufizohet brenda territorit.

### **Mbrojtja e shëndetit të njeriut**

Subjekti të marrë të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e sigurisë në punë, shëndetit dhe mirëqënien e personave të përfshirë në këtë veprimtari. Subjekti të zbatojë rregulloret ekzistuese të sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë në momentin e kryerjes së Operacioneve. Masat e ndihmës së parë në rast aksidenti duhet respektuar rregullorja perkatese e hartuar për këto qëllime. Largimi në ajër të pastër, e në rast të komplikacioneve të jepet ndihma e parë, e pastaj të kërkohet ndihma mjekësore.

### **Ndikimet pozitive të aktivitetit.**

Ka ndikime mjaft pozitive sepse trajtohen mbetjet që gjatë gjithë kohës kanë qenë stoqe dhe nuk janë rigjeneruar. Në këtë mënyrë ulet sasia e mbetjeve që depozitohen në landfillin e mbetjeve të kombinatit, minimizohet ndotja e mjedisit etj

Veç sa sipër leverdia e objektit konsiston dhe në gjenerimin e të ardhurave që do të derdhen në arken e Bashkisë si rezultat i aktivitetit.

Po kështu do të punësohet një numër jo i vogël punonjësish duke i ardhur në ndihmë problemit social të papunësisë.

### **PROGRAMI MONITORIMEVE**

Ky program do të fokusohet në mbledhjen e të dhënave mjedisore të veprimtarisë së subjektit dhe përdorimin e tyre për përmirësimin e mënyrës së operimit dhe korigjimit apo marrjen e masave shtesë të nevojshme për mbrojtjen e mjedisit. Programi i monitorimit të veprimtarisë do të zbatohet sipas fazave të zbatimit të projektit dhe dote përmbaje indikatorët e më poshtëm:

1. Vezhgimi i elementeve mjedisore (toka, ajër, ujë etj):
2. Emetimin e pluhurave;
3. Emetimin e zhurmave;
4. Emetimin e ndotjeve kimike;
5. Rastet e aksidenteve;
6. Punime rehabilituese.



EMERTIMI	MASAT	PERGJEGJESI	SHENIME
Ndotjet e ajrit gjate perpunimit te skorjeve	-marrja e masave perkatese per minimizimin e ketyre ndotjeve sidomos gjate periudhave te thatesirave te njomen ambjentet e punes here pas here me uje.	Subjekti	Vazhdimisht
Mbetjet gjate ushtrimit te aktivitetit te linjes se prodhimit	Rigrupimi i tyre dhe riciklimi ne proceset pas ardhies Nderkohe materiali duhet te grumbullohet ne nje vend te caktuar per ti derguar ne vend e caktuar ne mynyre periodike.	Subjekti	Mbetjet e dala te evadohen ne vendin e vcaktuar
Dekantimi i ujrave tenologjike	Do trajtohen ujrart siperfasore per te kaluar ne kanalim e tyre.	Subjekti	Trajtimi i kanalizimeve nepermjet pastrimit
Mbetjet gjate proceseve te perpunimit te produkteve qe trajtohen ne magazine si letra, kartona, plasmase amballazhi thase letre te grisura etj.	Per te gjitha mbetjet te dergohen ne vend depozitimin e tyre dhe me teje te largohen per ne vendet e caktuara .	Subjekti	Vazhdimisht
Shkarkime te pluhurit ne atmosfere	Spucim i materialit gjate procesit te punes	Subjekti	Masat e marra shoqerohen me veprime konkrete sic jane: - sherbimi i makinave, sprucimi i materialit

## KONKLUSIONE

Nga ushtrimi i ketij aktiviteti permendim se:

- Aktiviteti zhvillohet ne nje zone qe nuk gezon asnje lloj statusi te veçante mbrojtjeje per vlera mjedisore sipas kerkesave te ligjit te zonave te mbrojtura.
- Aktiviteti zhvillohet ne nje siperfaqe pa probleme konfliktuale pasi eshte nje siperfaqe e marre me kontrate te rregullt nga investitori.
- Aktiviteti zhvillohet ne nje zone industriale, ku relativisht nuk ka zona te banuara dhe zhvillohet ne normalitet te plote dhe nuk sjell shqetesime ne zonen rreth e rrotull.
- Aktiviteti ka mbeshtetje te pushtetit lokal dhe komunitetit;
- Aktiviteti zhvillohet ne perputhje me kerkesat ligjore dhe vendimeve te Qeverise dhe shtetit Shqiptare duke zbatuar rregullat e vendosura per ruajtien e mjedisit;
- Gjate ushtrimit te aktivitetit trajtohen produkte te cilet kane qene shqetesim per komunitetin, pavarsisht se nuk jane mbetje te rrezikshme shqetesim per ndotje te mjedisit dhe qe jane te karakterit tregetues;
- Gjate ushtrimit te aktivitetit nuk demtohen vepra arti, monumentale etj;
- Gjate ushtrimit te aktivitetit nuk do te kete demtime te flores dhe faunes egzistuese ne zonen ku ushtrohet ky aktivitet;

Nga ana e tije subjekti angazhohet te realizoje çdo lloj punimi rehabilitimi dhe te zbatoje rregullat e duhura ne perputhje me legjislacionin mjedisor duke mbajtur kontakte te vazhdueshme me gjithe organet e specializuara per te gjitha problemet qe do te hase gjate aktivitetit dhe qe nuk mund te zgjidhen nga ana e saje.

Perfundimisht konkludojme se subjekti ka punuar dhe vazhdon te punoje per te plotesuar sa me mire kerkesat qe lidhen me ruajtien dhe permiresimet e me tejeshme te mjedisit duke i kushtuar vemendje te veçante ketij problemi nepermjet planifikimeve te ndermarra dhe atyre te prespektives duke plotesuar ne kete mynyre kushtet per tu paisur me Leje mjedisore.

**Administrator**

Hysni BAKU  
